

Emertimi dhe Forma ligjore
NIPT -i

DEHA 2010 SHPK
L03425410B

Adresa e Selise

Mbrostar; Fshati Vajkan, zona kadastrale nr--3695 numer pasurie -
154/4
FIER

Data e krijimit
Nr. i Regjistrimit Tregetar

25.10.2010
CN-456249-10-10

Veprimtaria Kryesore

Ne fushen e ndertimit .Punime dheu, sistemime, tarracime
terenesh etj Ndertime civile ,industriale etj.

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Ligjit Nr.25/2018 Date 10.05.2018 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare")

Viti 2023

Pasqyra Financiare jane individuale
Pasqyra Financiare jane te konsoliduara
Pasqyra Financiare jane te shprehura ne
Pasqyra Financiare jane te rumbullakosura ne

<u>PO</u>
<u>JO</u>
<u>LEKE</u>

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare

Nga **01,01,2023**
Deri **31,12,2023**

Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare

16.03.2024

PASQYRAT FINANCIARE TE USHTRIMIT KONTABEL 2023

Pasqyra e Pozicionit Financiar(Bilanci)

Për Periudhën 01 Janar-31 Dhjetor 2023

(Të gjitha balancat janë në lekë)

Nr	AKTIVI	Nr.Ne Pasqyren Shenimev	Viti raportues 31.12.2023	Viti paraardhës 31.12.2022
I	AKTIVET AFATSHKURTRA			
1	1 Aktivet Monetare	4		
1-1	> Banka	4-1	236,415	4,516,829
1-2	> Arka	4-2	-	-
	Totali 1		236,415	4,516,829
2	Investime :			
2-1	Në tituj pronësie të njëjësive ekonomike brenda grupit		-	-
2-2	Aksionet e veta		-	-
2-3	Të tjera financiare		-	-
	Totali 2		-	-
3	Të drejta të arkëtueshme	5		
3-1	Nga aktiviteti i shfrytëzimit		-	-
3-11	>Të arkëtueshme nga Klientet	5-1	150,668,608	101,824,002
3-12	>Klient të Dyshimit dhe per tu arkëtuar nga proceset gjyqësore	5-2	4,735,918	5,396,850
3-13	>Talitim Fitim	5-3	136,535	1,361,643
3-14	>Tvsh	5-4	160,291	1,110,502
3-15	Talitim mbi Dividentin		-	-
3-2	Nga njësitë ekonomike brenda grupit		-	-
3-3	Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		-	-
3-4	Të tjera	5-5	5,962,615	972,226
3-5	Kapital i nënshkruar i papaguar		-	-
	Totali 3		161,663,967	110,665,223
4	4 Inventari	6		
4-1	Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	6-1	706,371	1,909,370
4-2	Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte	6-2	-	-
4-3	Produkte të gatshme	6-3	-	-
4-4	Mallra	6-4	156,000	156,000
4-5	Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)		-	-
4-6	AAGJM të mbajtura për shillje		-	-
4-7	Parapagime për inventar e shërbime	6-5	20,651,545	25,363,212
	Totali 4		21,513,916	27,428,582
5	Shpenzime të shtyra	7	5,068,646	2,343,858
6	Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara		-	-
	TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA(I)		188,482,945	144,954,492
II	AKTIVET AFATGJATA			
1	Aktive financiare			
1-1	Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit		-	-
1-2	Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit		-	-
1-3	Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		-	-
1-4	Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		-	-
1-5	Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata		-	-
1-6	Tituj të tjerë të huadhënies		-	-
	Totali 1		-	-
2	2 Aktive afatgjata materiale	8		
2-1	Toka	8-1	1,014,000	1,014,000
2-2	Ndertesa	8-2	9,265,289	9,752,936
2-3	Implante dhe makineri	8-3	80,278,262	52,882,183
2-4	Të tjera Instalime dhe pajisje	8-4	711,502	586,459
2-5	Parapagime për aktive materiale dhe në proces	8-5	-	-
	Totali 2		91,269,053	64,235,578
3	3 Aktivet biologjike afatgjata		-	-
4	Aktive jo materiale		-	-
4-1	Koncesione, patenta, licenca, marka tregtare, të drejta dhe aktive të ngjashme		-	-
4-2	Emri Mire		-	-
4-3	Parapagime për AAJM		-	-
	Totali 4		-	-
5	Aktive tatimore të shtyra		-	-
	TOTALI I AKTIVEVE AFATGJATA (II)		91,269,053	64,235,578
	TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		279,751,998	209,190,070

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



PASQYRAT FINANCIARE TE USHTRIMIT KONTABEL 2023

Pasqyra e Pozicionit Financiar(Bilanci)

Për Perludhen 01 Janar-31 Dhjetor 2023

(Të gjitha balancat janë në lekë)

Nr	DETYRIMET DHE KAPITALI	Nr.Ne Pasqyren Shenimev	Viti raportues 31.12.2023	Viti paraardhës 31.12.2022
I	DETYRIMET AFATSHKURTRA	DI		
1	Titujt e huamarrjes		-	-
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	9	-	-
2-1	>Overdrifte bankare	9-1	9,666,804	10,012,183
2-2	>Detyrime ndaj institucioneve të kreditit	9-2	-	-
3	Arkëtime në avancë për porosi	10	8,807,673	-
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit ndaj furnitoreve	11	59,782,928	43,190,613
5	Dëftesa të pagueshme		-	-
6	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit		-	-
7	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		-	-
8	Të pagueshme ndaj punonjësve	12	5,662,528	1,268,780
9	Të pagueshme ndaj sigurimeve shoqërore	13	381,226	214,858
10	Të pagueshme për detyrimet tatimore-Tap	14	31,200	15,600
11	Të pagueshme për detyrimet tatimore-Tatim Fillim	15	-	-
12	Të pagueshme për detyrimet tatimore-TVSH	16	-	-
13	Tatim në burim	17	3,750	-
14-1	Divident për tu paguar dhe detyrime të tjera ndaj ortakëve	18	49,361,309	33,979,963
14-2	Të tjere	19	13,960	13,960
15	Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
16	Të ardhura të shtyra		-	-
17	Provizionet		-	-
	TOTALI I DETYR. AFATSHKURTRA (I)		133,711,378	88,695,957
II	DETYRIMET AFATGJATA			
1	Titujt e huamarrjes		-	-
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	20	-	-
2-1	>Qera Financiare	20-1	30,441,563.8	6,165,117
2-2	>Huamarrje afatgjata	20-2	-	-
3	Arkëtime në avancë për porosi		-	-
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit		-	-
5	Dëftesa të pagueshme		-	-
6	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit		-	-
7	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		-	-
8	Të tjera të pagueshme		-	-
9	Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
10	Të ardhura të shtyra		-	-
11	Provizione:		-	-
12	Detyrime tatimore të shtyra		-	-
	TOTALI I DETYR. AFATGJATA (II)		30,441,564	6,165,117
	TOTALI I DETYRIMEVE(I+II)		164,152,941	94,861,075
III	KAPITALI DHE REZERVAT			
1	Kapitali i Nënshkruar	21	15,300,000.0	15,300,000
2	Primi i lidhur me kapitalin		-	-
3	Rezerva rrvlerësimi		-	-
4	Rezerva të tjera	22	-	-
4-1	> Rezerva Ligjore	22-1	166,321	166,321.00
4-2	>Rezerva statutore	22-2	-	-
4-3	>Rezerva të tjera	22-3	86,862,675	86,095,581.00
5	Fitimet e pa shpërndara	23	-	-
6	Fitime (humbja) e vitit financiar	24	13,270,061	12,767,093.72
	TOTALI I KAPITALIT (III)	25	115,599,056	114,328,996
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT (I,II,III)		279,751,998	209,190,070

Shënime mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



PASQYRAT FINANCIARE TE USHTRIMIT KONTABEL 2023

Pasqyra e Performances (e te Ardhurave dhe Shpenzimeve)

(Bazuar ne klasifikimin e shpenzimeve sipas natyres)

Për Periudhën 01 Janar-31 Dhjetor 2023

(Të gjitha balancat janë në lekë)

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Nr.Ne Pasqyren e Shënimeve Shpjeguese	Per vitin e mbyllur me 31.12.2023	Per vitin e mbyllur me 31.12.2022
1	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	26	192,655,915	114,908,070
2	Ndryshimet ne inventarin te produkteve te gatshem dhe prodhimit ne proces	27	-	-
3	Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar	28	-	-
4	Te ardhurat te tjera nga veprimtarite e shfrytëzimit	29	1,452,400	-
5	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	30	(127,978,817)	(65,560,197)
5-1	Shpenzime per Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	30-1	(117,748,031)	(65,560,197)
5-2	Të tjera shpenzime	30-2	(10,230,787)	-
6	Kosto e Punes	31	(14,220,129)	(10,940,988)
6-1	Pagat e personelit	31-1	(12,185,200)	(9,370,887)
6-2	Shpenzimet e sigurimeve shoq. e shendet.	31-2	(2,034,929)	(1,570,101)
7	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	32	-	-
8	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	33	(16,731,891)	(12,729,721)
9	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	34	(16,298,733)	(9,216,815)
10	FITIM HUMBJE(PARA TATIMIT) NGA AKTIVITETI(1+2+3+4+5+6+7+8+9)	35	18,878,745	16,460,349
11	Te Ardhurat te tjera	36	-	-
11-1	1. Të ardhura nga njësitet ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitet ekonomike brenda grupit)	36-1	-	-
11-2	2. Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitet ekonomike brenda grupit)	36-2	-	-
11-3	3. Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitet ekonomike brenda grupit)	36-3	-	-
12	Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra	37	-	-
13	Shpenzime financiare	38	-	-
13-1	1. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitet ekonomike brenda grupit)	38-1	(2,460,655)	(1,309,233)
13-2	2. Shpenzime të tjera financiare	38-2	(576,759)	(125,941)
14	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet	39	(3,037,414)	(1,435,174)
15	Fitimi/Humbja para tatimit	40	15,841,331	15,025,175
16	Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	41	(2,571,270)	(2,258,081)
	1. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(2,571,270)	(2,258,081)
	2. Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë			
	3. Pjesa e tatim fitimit të pjesëmarrjeve			
17	Fitimi/Humbja e vitit	42	13,270,061	12,767,094
	Fitimi/Humbja e vitit per:			
	1.Pronarët e njësise ekonomike mëmë			
	2.Interesat jo-kontrolluese			

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e kësaj pasqyre financiare.



PASQYRAT FINANCIARE TE USHTRIMIT KONTABEL 2023

Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

Për Periudhën 01 Janar-31 Dhjetor 2023

(Të gjitha balancat janë në lekë)

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Nr.Ne Pasqyren e Shënimeve Shpjeguese	Per vitin e mbyllur me 31.12.2023	Per vitin e mbyllur me 31.12.2022
I	Fitimi/Humbja e vitit		13,270,061	12,767,094
II	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:			
	Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja	43-1		
	Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	43-2		
	Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktivet financiare të mbajtura për shitje	43-3		
	Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet	43-4		
	Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin			
III	Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	43	13,270,061	12,767,094
	Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse për:			
	1.Pronarët e njësisë ekonomike mëmë			
	2.Interesat jo-kontrolluese			



PASQYRAT FINANCIARE TE USHTRIMIT KONTABEL 2023

Pasqyra e rrjedhjes së parasë(cash flow)

Metoda Direkte

Për Periudhën 01 Janar-31 Dhjetor 2023

(Të gjitha balancat janë në lekë)

Nr	Pasqyra e fluksit monetar - Metoda Direkte	Nr.Ne Pasqyren e Shënimeve Shpjeguese	Per vitin e mbyllur me 31.12.2023	Per vitin e mbyllur me 31.12.2022
I	Fluksi Monetar nga Veprimtarite e Shfyrtezimit			
1	Mjete Monetare të arketuara nga Klientet	44	194,674,781	167,219,410
2	Mjete Monetare të Paguara ndaj Furnitoreve dhe Punonjësve	45	(159,937,779)	(122,069,341)
3	Pagesa të tjera	46	(18,080,779)	(20,466,184)
4	MM te ardhura nga veprimtarite	47	16,656,223	24,683,885
5	Interesi i Paguar(bankar)	48	(562,928)	(743,597)
6	Tatimi mbi Fitimin i Paguar	49	(1,346,162)	(1,224,136)
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	50	14,747,133	22,716,152
II	Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
1	Para neto të përdorura për blerjen e filialeve		-	-
2	Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve		-	-
3	Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	51	(12,445,301)	(6,939,704)
4	Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		-	-
5	Pagesa për blerjen e investimeve të tjera		-	-
6	Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera		-	-
7	Dividentë të arkëtuara		-	-
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	52	(12,445,301)	(6,939,704)
III	Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
1	Te ardhura nga Emetimi i Kapitalit aksionar		-	-
2	Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral		-	-
3	Hua të arkëtuara	53	4,464,772	205,476
4	Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë		-	-
5	Riblerje e aksioneve të veta		-	-
6	Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral		-	-
7	Pagesa e huave	54	-	(2,686,063)
8	Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare	55	(11,047,018)	(3,911,043)
9	Interesi i paguar		-	-
10	Dividendë të paguar	56	-	(5,200,000)
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	57	(6,582,246)	(11,591,630)
IV	Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	58	(4,280,414)	4,184,818
V	Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	59	4,516,830	332,011
VI	Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare			
	Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor(IV+V+VI)	60	236,416	4,516,830



"DEHA 2010" SHPK
NIPT L03425410B
FIER

PASQYRAT FINANCIARE TE USHTRIMIT KONTABEL 2023

85,989,327

Pasqyra e ndryshimeve te Kapitalit
Për Periudhen 01 Janar-31 Dhjetor 2023
(Të gjitha balancat janë në lekë)

Një pasqyrë e pa konsoliduar

Nr		Kapitali nënshkruar	Primi i Lidhur me Kapitalin	Rrezerva Rivlerësimi	Rrezerva ligjore	Rrezerva statutoare	Rrezerva të tjera	Filimi pasqyrendare	Fitim / Humbja e vitit	Totali	Interesa Jo-Kontrollues	Totali
I	Pozicioni me 31.12.2021	15,300,000	-	-	166,321	0	85,823,006	-	7,272,575	108,561,902	-	108,561,902
A	Efektet e ndryshimit të politikave kontabel											
II	Pozicioni Financiar i deklaruar me 01.01.2022	15,300,000	-	-	166,321	-	85,823,006	-	7,272,575	108,561,902	-	108,561,902
1	Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:											
1-1	Fitim neto i periudhes kontabel											
1-2	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:											
	Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin: 2022	-	-	-	-	-	-	-	12,767,094	12,767,094	-	12,767,094
2	Transaksionet me pronarët e njësive ekonomike të njohura direkt në kapital:											
2-1	Emetimi i kapitalit të nënshkruar											
2-2	Dividendë të paguar											
2-3	Kalimi i Fitimeve në Rezervë / Kapital											
	Totali i transaksioneve me pronarët e njësive ekonomike											
III	Pozicioni financiar i deklaruar me 31 dhjetor 2022	15,300,000	-	-	166,321	-	86,095,581	-	12,767,094	114,328,995	-	114,328,995
IV	Pozicioni financiar i deklaruar më 1 janar 2023	15,300,000	-	-	166,321	-	86,095,581	-	12,767,094	114,328,995	-	114,328,995
1	Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:											
1-1	Fitim neto i periudhes kontabel											
1-2	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:											
	Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin: 2023	-	-	-	-	-	-	-	13,270,061	13,270,061	-	13,270,061
2	Transaksionet me pronarët e njësive ekonomike të njohura direkt në kapital:											
2-1	Emetimi i kapitalit të nënshkruar											
2-2	Dividendë të paguar											
2-3	Kalimi i Fitimeve në Rezervë / Kapital											
	Totali i transaksioneve me pronarët e njësive ekonomike											
V	Pozicioni financiar i deklaruar më 31 dhjetor 2023	15,300,000	-	-	166,321	-	86,862,674	-	13,270,061	115,599,056	-	115,599,056



"DEHA 2010" SHPK
NIPT L03425410B
FIER
PASQYRAT FINANCIARE TE USHTRIMIT KONTABEL 2023
Për Periudhën 01 Janar-31 Dhjetor 2023
Shënime për pasqyrat financiare
(Të gjitha balancat janë në lekë)

Sqarim:

Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 2.
Plotesimi i te dhenave të kësaj pjese duhet të bëhet sipas kërkesave dhe strukturës standarte të percaktuara në SKK 2 dhe konkretisht paragrafeve 86-93. Rradha e dhenies se spjegimeve duhet te jete :
a) një deklaratë që pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
(b) një përmbledhje të politikave kontabel të rëndësishme të zbatuara;
(c) informacion mbështetës për zërat e paraqitur në pasqyrat financiare, në rendin në të cilin paraqitet çdo pasqyrë dhe zë përkatës;
(d) shënime të tjera shpjeguese.

1 Informacion i përgjithshëm

Shoqëria DEHA 2010 SHPK është themeluar me dt.25.10.2010 me kapital të regjistruar 153000000 leke.Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme: -Hetem Seitaj zotërues i 50% të kapitalit të Shoqërisë;-Ilir Seitaj zotërues i 37% të kapitalit të Shoqërisë;-Bardhyl Seitaj zotërues i 12% të kapitalit të Shoqërisë;-Alfred Seitaj zotërues i 1 % të kapitalit të Shoqërisë; Administrimi i shoqërisë bëhet nga z.Bardhyl Seitaj kohëgjatja e mandatit te te cilevit është deri me 22.12.2025

Objekti Kryesor i veprimtarisë:Ne fushen e ndertimit .Punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh etj..Ndertim rruge automobilistike.Veshje me asfalto beton te rrugeve (ndertim mbi shtese) si dhe sistemime dhe asfaltim shesheshNdertim ujesjellsa dhe kanalizime, ndertim vepra kullimi, ujitje toke etj.Ndertim vepra arti rrugoreRikonstruksione godinash civile ekonomike, veshje fasadash etj.Ne fushen e transportit.Transport dhe tregtim me shumice dhe pakice, import dhe eksport artikuj te ndryshem indrustal si lende te para material ndertimi, makineri dhe pajise, pjese kembimi per makineri dhe automjete

Adresa e ushtrimit te veprimtarise eshte :Fier Mbrostar Vaikan Fshati Vajkan, zona kadastrale nr--
3695 numer pasurie nr- 154/4.

Nr punonjesve dhe fondi I	Nr punonjsve			Pagat Bruto		
	Viti 2023	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2023	Viti 2022	Viti 2021
Janar	17	18	19	767000	785900	689000
Shkurt	18	20	18	761800	848860	789100
Mars	19	19	19	883600	806300	855455
Prill	18	17	20	890000	784000	847000
Maj	20	18	20	921900	797500	900000
Qershor	21	18	19	1012500	823727	840000
Korrik	22	17	20	1006300	718500	881000
Gusht	20	15	20	977800	673100	900000
Shtator	21	16	19	1150000	768000	850000
Tetor	22	17	19	1186400	791900	752000
Nentor	25	17	15	1261500	803000	665000
Dhjetor	26	18	16	1366400	770100	694000
Shuma				12185200	9370887	5725600
Dite te Punuar	5101	4198	4579			
Nr Mesatar I Punonjsve	21	17	13			

2

Deklarata e perputhshmerise dhe Baza e pergatitjes se PF

2.1 Deklarata e Perputhshmerise

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit

Kuadri ligjor: Ligji 25/2018 dt 10.05.2018 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"

2.2

Baza e pergatitjes se PF

Baza e pergatitjes se PF : Te drejtat dhe detyrimet e konstatuara (SSK 1, 41)



"DEHA 2010" SHPK
NIPT L03425410B
FIER
PASQYRAT FINANCIARE TE USHTRIMIT KONTABEL 2023
Për Periudhën 01 Janar-31 Dhjetor 2023
Shënime për pasqyrat financiare
(Të gjitha balancat janë në lekë)

Me qëllim që të përmbushin objektivat e tyre, pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj metode, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (dhe jo kur paraja ose ekuivalentet e saj arkëtohen ose paguhen) dhe njihen në kontabilitet e raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin. Pasqyrat financiare, të përgatitura në bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, i informojnë përdoruesit jo vetëm mbi transaksionet e shkuara të shoqëruara me arkëtime dhe pagesa, por edhe mbi detyrimet për t'u paguar në të ardhmen si dhe mbi aktive që do të sjellin arkëtime në të ardhmen. Në këtë mënyrë, ato paraqesin informacione mbi transaksionet dhe ngjarjet e shkuara të cilat u shërbejnë përdoruesve më së miri në marrjen e vendimeve ekonomike.

Parimet dhe karakteristikat çesore të përdorura për hartimin e P.F. : (SKK 1; 40-90)

a) Njësia ekonomike mban llogari të aktiveve, detyrimeve dhe transaksioneve ekonomike të veta të veçanta nga ato të aktiveve, detyrimeve dhe transaksioneve ekonomike të aksionarëve, kreditorëve, punonjësve, klientëve si dhe personave të tjerë

b) Vijimësia e veprimtarisë ekonomike të njësive sone raportuese është e siguruar dukë mos pasur nevojë ndërprerjen e aktivitetit të saj.

c) KOMPENSIM midis një aktivi dhe një pasivi nuk ka, ndërsa midis të ardhurave dhe shpenzimeve ka vetëm në rastet që lejohen nga SKK.

d) KUPTUSHMERIA e Pasqyrave Financiare është realizuar në masën e plotë për të qenë të qarta dhe të kuptueshme për përdorues të jashtëm që kanë njohuri të përgjithshme të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit.

e) MATERIALITETI është vlerësuar nga ana jone dhe në bazë të tij Pasqyrat Financiare janë hartuar vetëm për zera materiale.

f) BESUSHMERIA për hartimin e Pasqyrave Financiare është e siguruar pasi nuk kagabime materiale duke zbatuar parimet e mëposhtme :

- Parimin e paraqitjes me besnikëri ; - Parimin e përparesisë së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore ; - Parimin e paaneshmerisë pa asnjë influencim të qëllimshëm ; - Parimin e maturisë pa optimizim të tepruar, pa nën e mbivlerësim të qëllimshëm ; - Parimin e plotësisë duke paraqitur një pamje të vertetë e të drejtë të PF; - Parimin e qëndrueshmërisë për të mos ndryshuar politikën e metodat kontabel ; - Parimin e krahasueshmërisë duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

2.3 Baza e matjes së Aktiveve dhe detyrimeve

Matja fillestare e aktiveve dhe detyrimeve që plotësojnë kriterin e njohjes, bëhet me koston historike

2.4 Monedha funksionale dhe Raportuese

Pasqyrat financiare janë paraqitur në monedhën shqiptare lekë

2.5 Përdorimi i Vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK kërkon që drejtimi i njësive ekonomike të kryej gjykime çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabel dhe shumeve të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale të këtyre mund të ndryshojnë sipasojë e këtyre çmuarjeve

2.6 Provizionet. Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi venëanrsh të rastin e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të detyrimit aktual si rrjedhojë e ngjarjeve të shkuara në raste të mundësia të ndodhjes vlerësohet të jetë me shumë se 50% në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit të cilat mund të matet me besueshmëri. Për shkak të niveleve të larta të pasigurisë në disa raste mund të ndodh që vlerësimi mund të mos jetë në një linjë me rezultatet faktike të çështjes. Drejtimi vlerëson në fund të periudhës nëse ka nevojë për krijimin e provizioneve. Në rast se njësia ekonomike jep garanci për produktet që ajo shet, në pasqyrat financiare të njësive do të njihet një provizion i barabartë me shumën e nevojshme për shlyerjen e detyrimeve të garancisë për produktet e shitura deri në datën e raportimit. Për vlerësimin e provizioneve do të merret për bazë përvoja e mëparshme.

Standard SKK 2 i përmirësuar do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël, që fillojnë më ose pas datës 01.01.2015. Ky Standard duhet të zbatohet në mënyrë prospektive.

Ndryshimet e SKK 2 të përmirësuar, të publikuara në vitin 2018, do të zbatohen në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël që fillojnë më ose pas datës 01.01.2019. Ndryshimet zbatohen në mënyrë prospektive.

3 Politika Kontabël të rëndësishme

Shoqëria ka aplikuar në mënyrë të qëndrueshme politikën e mëposhtme kontabel për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare:

3.1 Transaksionet në monedhe të huaj



"DEHA 2010" SHPK
NIPT L03425410B
FIER
PASQYRAT FINANCIARE TE USHTRIMIT KONTABEL 2023
Për Periudhën 01 Janar-31 Dhjetor 2023
Shënime për pasqyrat financiare
(Të gjitha balancat janë në lekë)

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zërat monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022 është detajuar si më poshtë

EURO	euro	103.88	114.23
Dollar Amerikan (USD)	Usd	93.94	107.05
Poundi Britanik (GBP)	GBP	119.47	128.92

3.2 Instrumentat financiare

Instrumentat financiare jo derivative përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiare jo derivativ enjihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë.

Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë në përmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura.

Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiar jo derivative maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet në se Shoqëria bëhet pa lënë kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfittimet thelbësore të aktivit.

Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen

3.2.1 Mjetet monetare ne arke dhe ne banke jane vleresuar sipas(SKK 3)

Mbeshtetur ne SKK 12 Monedhat e huaja jane vleresuar ne monedhen leke ne fund te periudhes me Kursin ZyrtarKurse te Këmbimit me 31.12.2023 jane 1 euro=103.88 leke

3.2.2 Aktive te tjere financiare jane rregjistruar ne perputhje me (SKK 3)

a

Për mallrat, produktet dhe shërbimet e shitura një klienti me një kredi afatshkurtër, është njohur si llogari e arkëtueshme me vlerën e paskontuar të mjeteve monetare të arkëtueshme nga ajo njësi, që është normalisht çmimi i faturës.(SKK 3 Paragrafi 13 /2)

b Të drejtat të arkëtueshme në një monedhë të huaj janë trajtuar sipas SKK 3. Dhe çdo ndryshim në drejtat e arkëtueshme për shkak të një ndryshimi në kursin e këmbimit është njohur në fitim ose humbje siç kërkohet nga SKK 12 Efëkti i ndryshimeve të kurseve të këmbimi

c Aktivët financiarë dhe huat e dhena që nuk kanë një normë interesi të deklaruar dhe janë të klasifikuara si aktive afatshkurtra maten fillimisht me shumën e paskontuar në përputhje me paragrafin 15(a)

3.3 Inventari Per percaktimin e kosos se inventareve eshte zgjedhur metoda mesatare e ponderuar

a Njohja, njësia ekonomike i njehë inventarin atëhere kur e ka nën kontroll, pret përfitime ekonomike prej tij dhe kostoja e tij mund të vlerësohet me besueshmëri

b Matja fillestare:Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin: koston e të gjitha materialeve të lidhura drejtpërdrejt me prodhimin si dhe koston e shndërrimit të këtyre materialeve në produkte përfundimtare. Kostot e drejtpërdrejta të materialeve përfshijnë, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.Kostoja e lëndëve të para, materialeve të konsumit, tokës dhe ndërtesave të blera për rishitje, përbëhet nga çmimi i blerjes, shpenzimet e transportit, taksat e importit, magazinimi, zbritjet dhe shtesat tregtare dhe të tjera shpenzime të tjera të ngjashme (taksat e parimbursueshme).

c Pas njohjes, njësia jone ekonomike e matë inventarin me vlerën më të ulët midis kosos dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për tu përfunduar dhe shitur.

d Çregjistrimi:Inventarin njësia jone ekonomike e çregjiston atëhere kur e shet. Njësia ekonomike e çregjistonë inventarin edhe në ato raste kur ai nuk ka më vlerë ekonomike në të ardhmen, si për shembull inventari i vjetëruar.Ne te tilla raste Njësia jone ekonomike ja merron institucionet perkatese per prezencen e tyre dhe monitorimin e procesit te asgjesimit te inventarit



Për të përcaktuar koston e produktit homogjen, përdorim mesataren e ponderuar. Për produkte jo homogjen përdorim Metoda e koston bazuar në identifikimin e specifik

f "Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces". Rritja e gjendjes së inventarit do të tregohet si një pakësim i shpenzimeve ("shpenzime negative") dhe pakësimi i gjendjes së inventareve do të tregohet si një rritje të shpenzimeve; Paragrafi 32 i SKK4

3.4 Aktive afatgjata materiale

a Njohja dhe matja

Vlerësimi fillestar i një elementi të AAM që plotëson kriteret për njohje si aktiv në bilanc është vlerësuar me kosto. (SKK 5; 19)

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve

b Kostot e mëpasshme

Për vlerësimi i mëpasshem i AAM është zgjedhur modeli i koston duke i paraqitur në bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar. (SKK 5; 18)

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabel të atij zëri nëse është e mundur që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzime kur ato ndodhin

c Amortizimi

Për llogaritjen e amortizimit të AAM (SKK 5; 38) njësia jone ekonomike ka përcaktuar metodën e vlerësimit të mbetur ndërsa normat e amortizimit janë përdorur të njëllojta me ato të sistemit fiskal në fuqi dhe konkretisht:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit	
		2023	2022
Ndërtesa	Vlera e Mbetur	5%	5%
Makineri dhe pajisje	Vlera e Mbetur	20%	20%
Mjete transporti	Vlera e Mbetur	20%	20%
Mobilje dhe orëndi	Vlera e Mbetur	20%	20%
Pajisje informatike	Vlera e Mbetur	25%	25%

ç Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Aktivet Afatgjata Jomateriale

Aktivët afatgjata jomateriale që kanë një jetë të përcaktuar maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Amortizimi llogaritet mbi koston e blerjes së aktivit të zvogëluar me vlerën e tij të mbetur. Shuma e amortizimit kalon në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në mënyrë zbritëse përgjatë jetës së aktivit

3.6 Huat dhe obligacionet janë rregjistruar në përputhje me (SKK 3)

Për mallrat, produktet e shërbimit e blera nga një furnizues me kredi afatshkurtër, janë njohur si një llogari e pagueshme me shumën e paskontuar që i detyrohet furnizuesit, që është normalisht çmimi i faturës. (SKK 3 Paragrafi 14/2)

Detyrime të pagueshme në një monedhë të huaj trajtohen sipas SKK 3. Dhe çdo ndryshim në detyrimet e pagueshme për shkak të një ndryshimi në kursin e këmbimit njihet në fitim ose humbje siç kërkohet nga SKK 12 Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimi

Për një hua afatgjatë të marrë nga një bankë, është njohur një llogari e pagueshme fillimisht me vlerën aktuale të mjeteve monetare të pagueshme ndaj bankës (psh duke përfshirë pagesat e interesit dhe të principalit). Njohja e mëpasshme me koston e amortizuar



Detyrimet financiare që nuk kanë një normë interesi të deklaruar dhe janë të klasifikuara si detyrime afatshkurtra, maten fillimisht me shumën e paskontuar në përputhje me paragrafin 15(a)

3.7 Aktive në përdorim dhe qeraja Financiare

Qeraja financiare është kontabilizuar sipas SNK 7 (34;35;36;37)

Shoqëria njihet të drejtën e përdorimit të një aktivi dhe një detyrim qiraje në datën e fillimit të qirasë. Aktivit me të drejtën e përdorimit fillimisht matet me kosto, i cili përfshin shumën fillestare të detyrimit të qirasë të rregulluar për çdo pagesë qiraje të bërë në ose para datës së fillimit, plus çdo shpenzim fillestar të drejtpërdrejtë të kryer dhe një vlerësim të kostove për çmontimin dhe largimin ose rivendosjen e aktivit ose zonës së vendndodhjes në të cilën është, duke zbritur çdo përfitim të marrë. Aktivit me të drejtë përdorimi amortizohet më pas duke përdorur metodën lineare nga data e fillimit deri në fund të jetës së dobishme të aktivit ose në fund të afatit të qirasë financiare.

3.8 KAPITALI DHE REZERVAT

Kapitali i Nënshkruar

Kapitali i Nënshkruar është në formën e kuotave. Numri i përgjithshëm i kuotave është 15300 të cilat u perkasin ortakëve të shoqërisë sipas kontributit të tyre në kapitalin themeltar

Shpërndaja e Fitimeve(Dividendët)

Shpërndarja e fitimit për ortakët njihet në pasqyrat financiare të shoqërisë si detyrim në periudhën në të cilën janë aprovuar nga Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë.

3.9 Të ardhurat

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve : Të ardhurat e perfituara nga shitja e produkteve, mallrave dhe shërbimeve gjatë periudhës kontable janë vlerësuar sipas SKK 8 të ardhurat

Të ardhurat nga shitja e mallrave: Të ardhurat e perfituara nga shitja e produkteve, mallrave dhe shërbimeve gjatë periudhës kontable janë vlerësuar sipas SKK 8 të ardhurat (a) njësia ekonomike ia ka kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave dhe produkteve; (b) njësia ekonomike nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe të produkteve në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura; (c) shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; (d) është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren nga njësia ekonomike; (e) kostot që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat nga shitja e Shërbimeve: Kur rezultati i një transaksioni që përfshin ofrimin e një shërbimi mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, një njësia ekonomike do të njohet të ardhurat e lidhura me transaksionin duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese (nganjëherë referuar si metoda e përqindjes së përfundimit). Rezultati i një transaksioni mund të vlerësohet me besueshmëri kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme: (a) shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; (b) është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në njësinë ekonomike; (c) faza e përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese mund të matet me besueshmëri; (d) kostot e ndodhura për shërbimin, si dhe ato që do të ndodhin për përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri. Njësia jone ekonomike përdor metodën e inspektimit për të përcaktuar fazën e përfundimit të transaksionit. Nepermjet personelit teknik të ngritur nga kontraktori dhe nenkontraktori hartohet situacioni për shërbime dhe punime të kryera.

3.10 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi për llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të

3.11 Përfitimet e punonjesve

Në bazë të legjislacionit shqiptar njësia ekonomike është e detyruar të derdh kontribute për punonjësit e llogaritur mbi pagat e kontraktuara. Pagesat për kontribute të sigurimit shoqërorë e shëndetësor janë llogaritur në masën 27.9% të pagesës kontraktuar. 16.7% e kontributeve të llogaritur mbi pagën janë njour si shpenzime të periudhës dhe 11.2% e pagesës është pjesa që paguhet nga punëmarresit

3.12 Tatimi mbi fitimin

